



RAPORT PËRMBLEDHËS I FUSHATËS  
“16 DITËT E AKTIVIZMIT KUNDËR  
DHUNËS ME BAZË GJINORE” 2023

**SOT DHE ÇDO  
DITË TJETËR**

# PËRMBAJTJA

Hyrje	1
Sllogani	2
Ceremonia Hapëse	3
Ndriçimi i Objekteve me ngjyrë Portokalli	4
Ora e Parë e mësimit – Ligjeratë kundër dhunës me bazë gjinore, dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje	5
Filma dhe Shfaqje Teatrale	7
Mbrëmje Koncertale	9
Video dokumentaret e shkurtra	10
Lansimi i Masës së Punësimit për Gratë Viktima të Dhunës	11
Programi Kombëtar për Kryerësit e Dhunës ndaj Grave	12
Bashkëbisedim me nxënësit në 7 regjionet e Kosovës	13
ATO janë NE	14
Kafe me Gratë Afgane dhe Ukrainase	15
Aktivitetet me Personat me Nevoja të Veçanta	16
Ekspozita “Traumë në Letër”	17

Punëtori për Vetëmbrojtje	18
Bashkëpunimi me Bashkësitë Fetare	19
Aktivitet në Tren	20
Kafe me Gratë nga Fshati	20
Vizitat dhe Bashkëpunimi me Gratë e Komuniteteve jo shumicë në Kosovë	21
Tryezë “Trajtimi Institucional i Rasteve të Dhunës në Familje”	22
Poezi për gruan	24
Turniri i Volejbollit	25
Ekspozitat dhe murali në Mitrovicën e Veriut	26
Realizimi i të drejtës së grave në trashëgimi	27
KONFERENCA RAJONALE “TË BASHKUAR KUNDËR DHUNËS - MJAFT!”	28
Lansimi i 3 Moduleve të Reja	30
Demo Debati	31
Aktivitetet në Qendrat Korrektuese	32
Bashkë organizim i Aktiviteteve	33

**Ministria e Drejtësisë**

Adresa: Luan Haradinaj, pn. Ndërtesa e ish Rilindjes - Ndërtesa e Qeverisë  
10 000 Prishtina, Kosova  
Tel: 038/200-67 035

E-mail: [zqp.md@rks-gov.net](mailto:zqp.md@rks-gov.net)

Facebook: <https://www.facebook.com/MinistriaeDrejtësisë>

Instagram: <https://www.instagram.com/ministriaedrejtësisë.rks/>

# HYRJE

“16 Ditët e Aktivizmit Kundër Dhunës me Bazë Gjinore” është një fushatë globale e iniciuar në vitin 1991 nga Qendra për Leadership Global të Grave. Kjo fushatë vjetore fillon më 25 nëntor – në Ditën Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave dhe zgjat deri më 10 dhjetor – në Ditën Ndërkombëtare të Drejtave të Njeriut. Fushata është lansuar me synimin për të tërhequr vëmendjen dhe për të mobilizuar veprime kundër një prej shkeljeve më të përhapura dhe më të vazhdueshme të drejtave të njeriut në botë – dhunës me bazë gjinore. Me kalimin e viteve, fushata është rritur për t’u bërë një platformë e fuqishme për ndërgjegjësimin dhe avokimin për eliminimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave. Fushata bashkon individë, organizata dhe qeveri në një përpjekje kolektive për të sfiduar dhe ndryshuar status quo-në.

Ministria e Drejtësisë edhe këtë vit për herë të dytë ka organizuar mbi 80 aktivitete të cilat kanë adresuar çështjen komplekse dhe fenomenin e të gjitha formave të dhunës me bazë gjinore në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Gjatë fushatës kemi bashkëpunuar me ministritë e linjës, zyrën e Presidentes, partneret tanë institucional, strategjikë, si dhe agjencitë ndërkombëtare.

Për t’i bërë jehonë mesazhit që të gjithë duhet të punojmë së bashku për të parandaluar dhe për t’i dhënë fund të gjitha formave të dhunës ndaj vajzave dhe grave, ndërtuam synimet e qarta duke i orientuar në tri objektiva kryesore:

- Shtrirjen në tërë territorin e Republikës së Kosovës;
- Shpërndarjen e mesazhit në secilën shtëpi;
- Përfshirjen e të gjitha grup-moshave dhe të gjitha komuniteteve;

**Në këtë raport përmbledhen të gjitha aktivitetet e fushatës.**

# SLLOGANI

Pas pranimit të shumë propozimeve, diskutimit të brendshëm me partnerë dhe organizatat e shoqërisë civile, si slogan i fushatës për vitin 2023 u vendos “SOT DHE ÇDO DITË TJETËR”.

“SOT DHE ÇDO DITË TJETËR” është thirrja dhe angazhimi kolektiv për kundërshtimin e dhunës në secilën formë të saj, jo vetëm brenda 16 ditëve të aktivizmit, por çdo ditë.

**SOT DHE  
ÇDO DITË  
TJETËR**



# CEREMONIA HAPËSE

Fushatën e filluam me një ceremoni zyrtare dhe institucionale. Në praninë e ambasadorëve, misioneve diplomatike, organizatave të shoqërisë civile, strehimoreve, organizatave ndërkombëtare, aktivistëve dhe aktivisteve feministe.

Ministrja Haxhiu, Kryesuesi Zogaj, Igo Rogova, Arnhild Spence, Jubilea Kabashi, iu drejtuan të pranishmëve me fjalë rasti.

Në këtë pritje, është shfaqur edhe një instalacion me rrëfime dhe histori të vërteta të vajzave dhe grave viktime.



# NDRIÇIMI I OBJEKTEVE ME NGJYRË PORTOKALLI

Në ditën e hapjes së Fushatës janë ndriçuar objektet institucionale dhe fetare në shenjë të bashkimit institucional për përkrahje të fushatës, të cilat janë të listuara më poshtë:

- Ndriçimi i objektit të ri Qeveritar, Ndërtesa ish-Rilindjes;
- Ndriçimi i objektit të Qeverisë;
- Ndriçimi i objektit të Presidencës;
- Ndriçimi i Minareve të Xhamive të Kryeqytetit;
- Ndriçimi i Katedralës;
- Ndriçimi i oxhakut të Termokosit;





# ORA E PARË E MËSIMIT – LIGJERATË KUNDËR DHUNËS ME BAZË GJINORE, DHUNËS NDAJ GRAVE DHE DHUNËS NË FAMILJE



Në bashkëpunim me MASHTI, edhe këtë vit në të gjitha shkollat e Kosovës, në nivelin fillor dhe të mesëm, në ditën e parë të fushatës është diskutuar për dhunën me bazë gjinore, dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje.

Me këtë rast ministret Haxhiu dhe Nagavci, në orën e parë të mësimit kanë vizituar shkollën fillore “Xhemail Mustafa”, ku kanë bashkëbiseduar aktivisht me nxënësit e asaj shkolle.



# BASHKËPUNIMI ME NDËRMARRJET PUBLIKE

Për realizimin e objektivës Nr. 2 “Shpërndarja e mesazhit në secilën shtëpi”, bashkëpunimi me ndërmarrjet publike ka qenë i domosdoshëm. Përmes bashkëpunimit me ndërmarrjet publike sllogani i fushatës “SOT DHE ÇDO DITË TJETËR” bashkë me mesazhet tona kundër dhunës dhe thirrjet për raportim, janë vendosur në faturat e energjisë elektrike, faturat e TERMOKOS dhe në faturat e të gjitha kompanive të ujësjellësve të komunave të Kosovës, KRU Prishtina, KRU Hidroregjioni Jugor, KRU Hidrodrini, KRU Hidromorava, KRU Bifurkacioni, KRU Mitrovica. Përmes

këtyre faturave, mesazhi ka arritur në secilën shtëpi në Republikën e Kosovës.

Përmes bashkëpunimit me Telekomin e Kosovës VALA, në ditën e hapjes së fushatës, mesazhi nga Ministria e Drejtësisë: “Ministria e Drejtësisë ka ashpërsuar dënimet për veprat penale të dhunës në familje dhe asaj me bazë gjinore. Mos dhuno! Raporto 192!” është dërguar tek të gjithë përdoruesit e VALA, pra tek mbi 800.000 përdorues.



Ministria e Drejtësisë ka  
ashpërsuar dënimet për veprat  
penale të dhunës në familje dhe  
asaj me bazë gjinore.  
Mos dhuno!  
Raporto 192!

# FILMA DHE SHFAQJE TEATRALE



Përmes filmave dhe shfaqjeve teatrale që trajtojnë pozitën dhe rolin e gruas në shoqëri, kemi synuar që nëpër komuna të ngjallim interesim dhe diskutim rreth temave të ndryshme. Prandaj në bashkëpunim me Qendrën Kinematografike të Kosovës, kemi organizuar shfaqjen e filmave në Komunën e Podujevës dhe Shtimes, të cilët kanë trajtuar fenomenin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, si dhe trafikimin dhe dhunën seksuale ndaj vajzave. Pas shfaqjes së filmave, bashkë me përfaqësues nga QKK dhe aktorë, regjisorë apo producent të filmave kemi zhvilluar bashkëbisedime me publikun prezent, duke prekur kështu tema të rëndësishme të cilat shpeshherë refuzohet të diskutohen.

- Filmi “ Vozitësi” Komuna Podujevë
- Filmi “ Salloni” Komuna Shtime
- Filmi “ Një muaj” Komuna Shtime

Filmat nuk janë shfaqur sipas planifikimit në Komunën e Prizrenit dhe Komunën e Lipjani për arsye të mos bashkëpunimit nga këto komuna. Edhe përkundër përpjekjes për të vendosur kontakte dhe bashkëpunim me komunat përkatëse, të njëjtat kanë neglizhuar kërkesat e Ministrisë së Drejtësisë për shfaqjen e filmave.

Ministria e Drejtësisë ka kontaktuar disa herë me komunat por nuk ka pasur gatishmëri.

**Shfaqjen “GRATË”** – ose mëkatet e tyre në patriarkat!” e shfaqëm dy herë përgjatë 16 ditëve të fushatës. Një udhëtim kaotik teator, provokim për shoqërinë që refuzon t’i pranojë problemet e veta, 6 gra artiste sjellin në skenë emocione të ndryshme e të shumta. Kjo shfaqje është një protestë artistike dhe thirrje për reflektim.

**Shfaqja “Molly”** është poashtu një shfaqje që depërton thellë në realitetin e jetës së një gruaje me nevoja të veçanta. Kjo shfaqje ndërgjyegjësuese është përqafim i diversitetit shoqëror.

**Shfaqja “Stiffler”**, trajton një realitet ende të hidhur të mendësisë patriarkale në institucione, përkatësisht keqtrajtimin institucional dhe shoqëror të viktimeve të prostitucionit.

**Shfaqja “GRATË”** dhe **“Molly”** u organizuan në bashkëpunim me Teatrin Kombëtar të Kosovës ndërsa shfaqja “Stiffler” u organizua në bashkëpunim me Teatrin Oda.



# MBRËMJE KONCERTALE



Filharmonia e Kosovës në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë ka organizuar një mbrëmje koncertale të veçantë më Korin e Femrave të Filharmonisë së Kosovës. Kjo mbrëmje koncertale ka shërbyer si një formë e veçantë e shprehjes artistike për të ndërgjegjësuar dhe informuar publikun rreth rëndësisë së parandalimit, adresimit dhe luftimit të dhunës ndaj grave, dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore si dhe solidarizimi me

vajzat dhe gratë viktimë të formave të ndryshme të dhunës. Një udhëtim muzikor i mahnitshëm i Korit të Femrave (Grave dhe Vajzave) të Filharmonisë së Kosovës, së bashku me muzikantët e ftuar dhe kuartetin e harqeve.

# VIDEO DOKUMENTARET E SHKURTRA



Duke pasur parasysh rëndësinë e parandalimit të dhunës në familje dhe formave të tjera të shkeljes së të drejtave të njeriut, përgjatë fushatës kemi lansuar tri video sensibilizuese të cilat kanë për qëllim që të ngri-sin vetëdijen shoqërore për pasojat e dhunës në familje, ngacmimet seksuale dhe bullizmi.

Videot vazhdojnë të shfaqen në Radio Televizionin Publik.

# LANSIMI I MASËS SË PUNËSIMIT PËR GRATË VIKTIMA TË DHUNËS



Për t'i fuqizuar ekonomikisht vajzat dhe gratë viktimë të dhunës si dhe për të rritur pavarësimin ekonomik, në bashkëpunim me MFPT lansuam Masën 1.8 "Mbështetja e punësimit të grave viktimë të dhunës në familje", në kuadër të Skemës "Qeveria për Familjet".

*Në bazë të kontakteve tona me vajzat dhe gratë, shumica e grave të mbijetuara të dhunës në familje janë të papuna. Pra sfida më e madhe është mungesa e një vendi të punës sikurse edhe strehimi, andaj ishim të përkushtuar që të ndërmarrim një masë të tillë tejet të rëndësishme.*



# PROGRAMI KOMBËTAR PËR KRYERËSIT E DHUNËS NDAJ GRAVE

Për herë të parë në shtetin tonë është bërë lansimi i Programit Kombëtar për Kryerësit e Dhunës ndaj Grave. Si një ndër aktivitetet kyçe të kësaj fushate, me pjesëmarrjen e Kryeministrit të Kosovës z. Albin Kurti, si dhe përfaqësuesve të institucioneve dhe organizatave partnere ndërkombëtare, Ministrija Haxhiu në Konferencën e përbashkët ka lansuar Programin Kombëtar për Kryerësit e Dhunës ndaj Grave, program ky që synon të ndryshojë sjelljet dhe mendësinë e kryerësve të dhunës nëpërmjet një rrugëtimi transformues që çon drejt sjelljeve jo

të dhunshme dhe të respektueshme në marrëdhëniet ndër personale. Me theks të veçantë, Programi përqendrohet në rehabilitimin e kryerësve, ndërkohë që synon të sigurojë mbështetje dhe siguri të nevojshme për viktimat e tyre.

Në punën disa mujore të Ministrisë së Drejtësisë për realizimin e këtij programi ndihmë të veçantë ka ofruar Këshilli i Evropës, organizatat ndërkombëtare, dhe zyrat e përfshira në krijimin e kurrikulës.





# BASHKËBISEDIM ME NXËNËSIT NË 7 REGJIONET E KOSOVËS



Këtë vit Ministria e Drejtësisë me qëllim të shtrirjes në tërë territorin e Kosovës për vetëdijësimin e nxënësve të shkollave të mesme, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit ka organizuar bashkëbisedime me nxënësit e shkollave të mesme në formatin e Townhalls, në idenë që të përfshihen nxënësit nga 7 regjionet e Kosovës. Townhalls janë zhvilluar në formatin e një paneli i cili ka qenë i përbërë nga Ministria apo zëvendësministrat e Drejtësisë, gjyqtarë, prokurorë, policë, mbrojtësit e viktimave, strehimoret, dhe përfaqësues të qendrave për Punë Sociale, të cilët me përvojën e tyre kanë informuar nxënësit për rëndësinë e raportimit të dhunës, ciklin e raportimit të dhunës, dhe luftimin institucional të saj. Kjo përbërje e paneleve pra është bërë qëllimshëm në mënyrë që nxënësit të dëgjojnë direkt nga cikli i institucioneve që merren me rastet e dhunës për punën e tyre dhe të shtrojnë pyetjet

që ata i kanë për secilin.

Gjatë këtyre bashkëbisedimeve ka pasur interesim të jashtëzakonshëm nga të rinjtë nga e gjithë Kosova duke marr pjesë masivisht dhe aktivisht në aktivitetet kështu duke e zhvilluar bashkëbisedim dinamik me panelistët me pyetje të vlefshme dhe shumë të rëndësishme.

Po ashtu, gjatë kohës sa zhvillohej debati, janë shpërndarë materialet sensibilizuese të fushatës për të gjithë të rinjtë.

Bashkëbisedimet janë organizuar në Mitrovicë, Prishtinë, Pejë, Prizren, Ferizaj, Gjakovë dhe Gjilan.

# ATO JANË NE



“ATO janë NE” është thirrja solidarizuese me vajzat dhe gratë e realizuar në formë të një aktiviteti simbolik për të vulosur se jemi të pa kompromis në luftën kundër dhunës me bazë gjinore dhe jemi bashkë me viktimat në secilin hap.

Në sheshin e Prishtinës “Zahir Pajaziti” është vendosur një tabelë e madhe e zezë me mbishkrimin “ATO janë NE” në të cilën më ngjyrë portokalli janë vendosur shenjat e duarve si formë e vulosjes për të dëshmuar qëllimin e këtij aktiviteti që në thelb ka kuptimin për një të ardhme pa dhunë me bazë gjinore, ku qytetarët kanë përdorur ngjyrë portokalli

për të lënë gjurmët e duarve të tyre si një deklaratë e fuqishme solidaritetit dhe angazhimit për ndryshim.

Në këtë aktivitet lanë gjurmë edhe Presidentja e Republikës së Kosovës, SH.S. Vjosa Osmani Sadriu, Ministrja Albulena Haxhiu, Ministrja Arbërie Nagavci, deputetë, profesorë, përfaqësues të institucioneve të ndryshme si dhe qytetarë kalimtarë në sheshin e Prishtinës.



# KAFE ME GRATË AFGANE DHE UKRAINASE



Ministrja Haxhiu nisi ditën e 4-të të fushatës me një aktivitet të veçantë dhe ndryshe. Kafën e mëngjesit e pimë me vajzat dhe gratë afgane dhe ukrainase të cilat qëndrojnë në Kosovë si refugjate për shkak të situatës në vendet e tyre.

Marrë parasysh se Republika e Kosovës para 25 vitesh ka kaluar të njëjtën situatë, pra luftën, ky aktivitet kishte për qëllim bashkëbisedimin dhe adresimin e dhunës ndaj grave në kohë lufte.

Gjatë luftës së fundit në Kosovë, bazuar në shumë raporte të organizatave që janë marrë me krime lufte, raportohet për rreth 20 mijë viktime të dhunës seksuale.



# AKTIVITETET ME PERSONAT ME NEVOJA TË VEÇANTA



Personat me nevojat të veçanta, shpeshherë nuk përfshihen aq në mënyrë të barabartë në procese të ndryshme për shkak të nevojave të veçanta, por, dhuna nuk njih dallime, ajo mund të jetë e pranishme në çdo grup shoqëror. Gjatë fushatës, vizituar Shoqatën e të Shurdhërve ku anëtarë të shumtë të shoqatës bashkëbiseduan me Ministren Haxhiu për shqetësimet e tyre. Në mbrëmjen e po të njëjtës ditë, bashkë me disa shoqata të personave me nevoja të veçanta, e ndoqëm shfaqjen “Molly” në Teatrin Kombëtar të Kosovës. Shfaqje e cila ka risjellur përjetimet e personave me aftësi të kufizuara, duke ndihmuar në ngritjen e ndërgjegjësimit ndaj sfidave dhe nevojave të tyre.



# EKSPOZITA “TRAUMË NË LETËR”



“Traumë në letër” është ekspozitë me punime të fëmijëve viktime të dhunës në familje apo dëshmitarë të dhunës. Përmes vizatimeve të fëmijëve, kemi dashur të shprehim ndikimin e dhunës tek ta, pra emocionet dhe përjetimet e tyre të brendshme që ndoshta edhe nuk i thonë asnjëherë me zë.

Ekspozita ka qenë e hapur për tre ditë, në Prishtinë. Vizatimet janë punuar nga fëmijët të cilët gjenden në strehimoret e Kosovës, të cilët kanë qenë ose viktime të dhunës ose dëshmitarë të dhunës ndaj nënave të tyre. Mbi 500 vizatime dhe lodra fëmijësh i kemi pranuar nga strehimoret, kuratorja e ekspozitës ka përzgjedhur vizatime të cilat kanë shprehur më shumë gjendjen emocionale të fëmijëve.

Kjo ekspozitë jashtëzakonisht prekëse, kishte për qëllim hapjen e diskutimit dhe reflektimin shoqëror sa i përket ndikimit të dhunës tek fëmijët.



# PUNËTORI PËR VETËMBROJTJE



Punëtorja për Vetëmbrojtje është një ndër aktivitetet më të pëlqyera dhe më atraktive të fushatës, të cilën Ministria e Drejtësisë e ka realizuar në bashkëpunim me xhudistët tanë me famë botërore, në hapësirat e palestrës së tyre, në qytetin e Pejës.

Nga të gjitha strehimoret e Republikës së Kosovës, janë ftuar gratë viktime të dhunës që të marrin pjesë dhe të mësojnë disa teknika të vetëmbrojtjes. Rreth 50 pjesëmarrëse kanë mësuar teknika dhe taktika elementare të vetëmbrojtjes nga kampionet botërore Majlinda Kelmendi, Nora Gjakova, Distria Krasniqi dhe xhudistë të tjerë, në krye me trajnerin Toni Kuka.

Përpos ushtrimeve fizike, Driton Kuka, vajzat kampione dhe Ministrja Haxhiu, kanë zhvilluar edhe bashkëbisedim me pjesëmarrëset ku kanë adresuar rëndësinë e shëndetit fizik dhe ndikimin pozitiv të tij edhe në shëndetin mendor.



# BASHKËPUNIMI ME BASHKËSITË FETARE



Ministria e Drejtësisë në kuadër të zbatimit të Strategjisë Kombëtare për mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022-2026 si dhe në kuadër të fushatës “16 ditët e aktivizmit kundër dhunës me bazë gjinore” ka nënshkruar memorandume bashkëpunimi me bashkësitë fetare me qëllim të ndërmarrjes së veprimeve të përbashkëta kundër dhunës në familje, dhunës ndaj grave dhe asaj me bazë gjinore.



Në këtë drejtim gjatë fushatës janë organizuar edhe bashkëbisedime me gra të bashkësive fetare si Bashkësia Islame e Kosovës dhe Kisha Katolike, ku kemi adresuar dhunën në familje dhe dhunën me bazë gjinore. Këto diskutime në grupe shoqërore dhe komunitete të ndryshme fetare janë të domosdoshme. Dhuna nuk është fenomen i izoluar, ajo mund të ndodhë në secili komunitet.



# AKTIVITET NË TREN

Aktiviteti në tren është realizuar nga Ministria e Drejtësisë dhe Agjencia për Ndihmë Juridike Falas në bashkëpunim me Trainkos. Zyrtarët e Ministrisë së Drejtësisë dhe zyrtarë të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas kanë udhëtuar me tren nga Prishtina në Pejë duke bashkëbiseduar me udhëtarët në tren, për t'i informuar rreth fushatës, dhunën në familje, femicidit, rëndësinë e raportimit dhe luftimit të dhunës si

dhe ofrimin e informacioneve për përfitimet që kanë viktimat nga programi i Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas.

Gjatë udhëtimit janë shpërndarë fletushka vetëdijësuese dhe me informacione rreth raportimit të dhunës, shërbimeve institucionale etj.

# KAFE ME GRATË NGA FSHATI

Fshatrat shpeshherë janë më larg informacionit dhe aktiviteteve për shkak të largësisë me qytetin apo për shkak të relievit dhe infrastrukturës. Vajzat dhe gratë nga fshati janë të barabarta, prandaj Ministria Haxhiu gjatë fushatës ka zhvilluar bashkëbisedime me gratë e fshatrave në Dragash dhe në Krushë. Në këto takime joformale dhe shumë miqësore me

gratë fisnike e shumë punëtore si dhe me vajzat me vizione dhe të ardhme të ndritur përpara, Ministria Haxhiu diskutoi për pozitën e gruas në shoqëri, angazhimin e Qeverisë për avancimin e vajzave dhe grave, rëndësinë e zhvillimit të fshatrave, njohjen e punës që bëjnë gratë dhe që nuk paguhet. Barazi dhe solidaritet.





# VIZITAT DHE BASHKËPUNIMI ME GRATË E KOMUNITETEVE JO SHUMICË NË KOSOVË



Vajzat dhe gratë e komuniteteve jo shumicë janë dyfish të shtypura në shoqërinë tonë dhe kjo nuk duhet të normalizohet. Ministrija Haxhiu ka zhvilluar takime formale dhe jo formale me gra të komuniteteve jo shumicë, duke theksuar çdo herë rëndësinë e fuqizimit dhe avancimit të tyre. Në Prizren u pritën në takime të ndara nga vajza dhe gra të komuniteteve Rom, Ashkali, Egjiptian, Turk dhe Boshnjak. Ndërsa në Fushë Kosovë na pritën vajzat dhe gratë e komunitetit Rom, Ashkali, Egjiptian.

Dëgjuam shumë nga ato, sfida, përpjekje, angazhime e përjetime.

Me kërkesë të Ministres Haxhiu, Qeveria e Kosovës ka krijuar Grupin Ndërmintor për parandalimin e martesave të hershme. I njoftuam rreth angazhimeve tona dhe filluam menjëherë me adresimin e kërkesave të tyre.

Në këtë drejtim, grave në Fushë Kosovë, pas kërkesës së tyre, ua kemi siguruar 7 maqina të qepjes, që ato të trajnohen dhe të aftësohen në këtë drejtim.



# TRYEZË “TRAJTIMI INSTITUCIONAL I RASTEVE TË DHUNËS NË FAMILJE”



Në qytetin e Gjilanit, organizuam tryezën e diskutimit me temën Trajtimi Institucional i Rasteve të Dhunës në Familje, tryezë kjo e cila për qëllim kishte të mbledhë në një vend të gjitha institucionet të cilat janë pjesë e ciklit të raportimit dhe trajtimit të rasteve të dhunës në familje. Me pjesëmarrës nga gjykatat, prokuroria, policia, mbrojtësit e viktimave, strehimoret, u diskutuan sfidat dhe angazhimi i tyre në adresimin dhe luftimin e dhunës në familje, dhunës ndaj grave dhe dhunës me bazë gjinore. Të pranishmit diskutuan shtruar dhe adresuan secilën kërkesë, kritikë dhe mendim.

Në diskutim janë përfshirë edhe hapat që janë ndërmarrë në fuqizimin e legjislatcionit dhe mekanizmave të tjerë që ndihmojnë në mbrojtjen e viktimave të dhunës, parandalimin dhe luftimin e kësaj dukurie.



# STREHIMORET DHE QENDRAT PËR PUNË SOCIALE

Me vendim të Qeverisë është aprovuar fondi shtesë për strehimoret dhe të gjitha OJQ-të e licencuara dhe të mandatura për të ofruar shërbime sociale dhe familjare. Ministria Haxhiu zhvillon vizita të rregullta gjatë tërë vitit në të gjitha strehimoret e Republikës së Kosovës në mënyrë që të njihet nga afër me nevojat e secilës prej tyre, ashtu që në bazë të kompetencave ligjore t'i ofrojmë ndihmën e nevojshme strehimoreve të cilat strehojnë viktimat e dhunës dhe të trafikimit me genie njerëzore.

Në kuadër të fushatës është realizuar vizita në strehimoren e Prizrenit nga zëvendësministri i Drejtësisë z. Vigan Qorrolli, i cili për së afërmi u njoftua me

kushtet e tyre, kërkesat dhe sfidat që kanë në strehimin dhe ofrimin e ndihmës për gratë dhe fëmijët që janë viktimat të dhunës.

Në kuadër të fushatës Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Agjencinë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar kanë mbështetur 10 Qendra për Punë Sociale me laptop dhe pajisje tjera elektronike, përmes të cilave do të kenë mundësi që të përmbushin në mënyrë më të lehtë dhe më efektive punët dhe detyrat e tyre.

Asetet e konfiskuara, në vazhdimësi do t'u ipen në shfrytëzim atyre që kanë nevojë.



# POEZI PËR GRUAN



Në hapësirat e Librarisë Dukagjini, organizuam Natën Poetike. Në një panel lexuesish ku ishin Ambasadori Abbott, aktorja Ilire Vinca, aktivisti Rron Gjinoçci, aktorja Njomza Fetiu, aktori Xhevdet Doda, dhe moderuar nga soprano Besa Llugiqi, dëgjuam poezi emancipuese dhe fuqizuese për vajzat dhe

gratë, por edhe poezi që adresonin dhunën ndaj gruas. Emocione të shumta, reflektime të përbashkëta përjetuan të gjithë.

Poezi u lexuan edhe nga të pranishmit në audiencë.



# TURNIRI I VOLEJBOLLIT



Në bashkëpunim me Federatën e Volejbollit të Kosovës kemi organizuar Turneun e Volejbollit të quajtur “Bashkë për Fuqizim”. Qëllimi i këtij turneu ishte që ekipi fitues, çmimin ta ndaj për ndonjë organizatë të grave, strehimore apo biznes te grave.

5 ekipe të formuara nga institucionet dhe bashkëpunëtorët, u zhvillua lojë të ndara deri në finale. Lojë të drejtuar nga referët profesional të Federatës së Volejbollit të Kosovës.

Ekipi fitues ka fituar shpërblimin e vendit të parë e i cili ka qenë një mijë euro. Kjo shumë e të hollave u është dedikuar për ofrimin e ndihmës për shkollim, arsimim dhe zhvillim të zanateve të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian në Fushë Kosovë.



# EKSPOZITAT DHE MURALI NË MITROVICËN E VERIUT



## Artefakte në Muzeun Kombëtar të Kosovës në luftën kundër dhunës me bazë gjinore

Në kuadër të fushatës është organizuar ekspozita nga Muzeu Kombëtar i Kosovës, në të cilën ka marr pjesë Ministrja Haxhiu, ku janë prezantuar 16 artefakte që dokumentojnë fuqinë, historinë, rolin dhe rëndësinë historike që ka pasur gruaja nëpër kohëra dhe kultura të ndryshme.

Ministrja Haxhiu morri pjesë edhe në ekspozitën “Motrat tona” nga artistja feministe, Ms. Indefinite, në të cilën është motërzuar kryevepra e pikturës shqiptare “Motra Tone” e piktorit Kolë Idromeno.

Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Komunën e Mitrovicës së Veriut kanë realizuar një Mural tek



Ura e Ibrit nga artistë të vendit, e cila për temë ka pasur dhunën në bazë gjinore. Murali i realizuar mban mbishkrimin “TO BE FREE IS TO HAVE NO FEAR”.

# REALIZIMI I TË DREJTËS SË GRAVE NË TRASHËGIMI



Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Odën e Noterëve të Kosovës ka realizuar një Panel Diskutimi me temën “Realizimi i të drejtës së grave në trashëgimi”, i përbërë nga profesionistë të Universitetit të Prishtinës, Noter dhe përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë, për të diskutuar rrethanat aktuale

në shoqërinë tonë sa i përket të drejtës së grave për të trashëguar pasuri, edukimi dhe arsimimi në këtë drejtim, rregullativat ligjore dhe zbatimimi i tyre, procedurat gjyqësore dhe noteriale, me fokus në të drejtat e grave – si të barabarta me burrat – në trashëgimi.



# KONFERENCA RAJONALE “TË BASHKUAR KUNDËR DHUNËS - MJAFT!”



Për herë të parë në rajon, Ministria e Drejtësisë dhe Zyra e Presidentes së Republikës së Kosovës, kanë bashkë organizuar Konferencën e Parë Rajonale dy ditore “Të Bashkuar Kundër Dhunës – MJAFT!”. Konferenca është përbërë nga 6 panele të ndryshme të cilat për temë kanë pasur dhunën ndaj grave, dhunën në familje dhe dhunën me bazë gjinore nga perspektivat e profesioneve të ndryshme, duke shkëmbyer praktikat më të mira të shteteve dhe sfidat e tyre në luftimin dhe adresimin e këtij fenomeni negativ të shoqërisë. Pjesë e paneleve dhe të ftuar tjerë në Konferencë, ishin përfaqësues të lartë të shtetit dhe nga profesione të ndryshme nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Bullgaria dhe Kroacia.

Me pjesëmarrje masive e interesim të veçantë, për dy ditë, pjesëmarrësit patën mundësi të dëgjojnë dhe bashkëbisedojnë me panelistët në përbërje: ministrat e Drejtësisë, përfaqësues nga sistemi i drejtësisë, deputetë, shoqëria civile, mediat dhe përfaqësues të institucioneve që japin mbështetje për fuqizimin ekonomik të grave nga i tërë rajoni.

Impakti që kjo Konferencë do të ketë në vendin tonë por edhe me gjerë, dëshmohet me interesimin dhe pjesëmarrjen e profesionistëve nga më të ndryshmit

gjatë 2 ditëve të Konferencës.

Kjo Konferencë, për herë të parë ka ngritur nivelin e diskutimit të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore në nivelet më të larta.

Në hapje, të pranishmëve iu drejtua edhe Kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, duke vulosur edhe njëherë angazhimin e Qeverisë së Kosovës në parandalimin dhe adresimin e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore.

Në mbyllje, Konferencës iu drejtuan SH.S. Presidentja Vjosa Osmani dhe përmes videomesazhit Kryeparlamentari Glauk Konjufca.

Në pamundësi të pjesëmarrjes fizike, videomesazhe u transmetuan edhe nga deputetja britanike dhe Kryetarja e Komisionit për Punë të Jashtme, Alicia Kearns, profesoresha e Utrecht University, Lorena Sosa.

Ligjerata të ndara trajtuan temat:

- Bodyright
- Women in Tech.



# PANAIRI I ORGANIZATAVE TË GRAVE



Me qëllim të promovimit dhe mbështetjes për iniciativat dhe bizneset e grave, është organizuar Panairi i grave i organizatave të shoqërisë civile që merren me mbrojtjen e grave, strehimoreve, si dhe bizneseve në pronësi të grave. Ky panair ka qenë i hapur për dy ditë si pjesë e Konferencës Rajonale “Të Bashkuar Kundër Dhunës – MJAFT!”



# LANSIMI I 3 MODULEVE TË REJA



Ministria e Drejtësisë ka bërë lansimin e 3 moduleve të reja në Databazën e të dhënave për evidentimin e rasteve të dhunës në familje. Në këtë databazë modulet janë inkuadruar për Shërbimin Korrektues të Kosovës, Shërbimin Sprovues të Kosovës, dhe Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas.

Në këtë ngjarje dhe për këtë qëllim janë certifikuar 111 policë nga të gjitha rajonet e Kosovës, të cilët kanë kryer trajnimet adekuate, si policë hetues të rasteve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

Tashmë në ueb faqen e Ministrisë së Drejtësisë ekziston kolona "Statistikat e Databazës", ku do të ofrohen të dhëna të hapura në çdo tre muaj për rastet e dhunës në familje, të cilën në këtë ngjarje Ministria Haxhiu ka bërë lansimin zyrtar të saj, me qëllim dhe synim të transparencës, bashkëpunimit dhe ofrimit të statistikave të sakta për gjithsecilin.

Zhvillimin dhe avancimin e kësaj baze të dhënash e kanë përkrahur Bashkimi Evropian, UN Women dhe UNDP.



# DEMO DEBATI



Në hapësirat e Ministrisë së Drejtësisë në bashkëpunim me Debate Center është organizuar Debat në formatin British Parliamentary. Ky turnamet është organizuar në formë të 4 ekipeve, me 8 debatues, dhe 4 gjyqtarë me përvojë në debatim dhe gjykim në debate të strukturuar. Gjatë debatit, debaterët argumentuan pro dhe kundër temës: “Kjo shtëpi beson që Policia e Kosovës duhet të ketë një departament vetëm me gra police”.



Debate të tilla, të strukturuar dhe me argumente konstruktive janë jashtëzakonisht të rëndësishme për zhvillimin e mendimit kritik për gjeneratat e reja. Rolet e debutuesve, pro dhe kundër, ishin të paracaktuara me short dhe argumentet e përdorura nuk do të thotë që janë mendimet e tyre personale.



# AKTIVITETET NË QENDRAT KORREKTUESE

Në Qendrat Korrektuese të Kosovës janë realizuar një sërë aktivitesh sensibilizuese dhe rehabilituese për personat që vuajnë dënimin me burgim. Këto aktivitete kanë për qëllim reflektimin e të burgosurve në raport me dhunën në familje dhe dhunën me bazë gjinore.

- Në të gjitha qendrat e paraburgimit dhe në Burgun e Sigurisë së Lartë është bërë shpërndarja e broshurave “ Rritja e ndërgjegjësimit për Dhunën në Familje – Konventa e Stambollit”.
- Në qendrën korrektuese për Gra në Lipjan dhe në Burgun e Sigurisë së Lartë në Smrekonicë është realizuar shfaqja e dokumentarit “Përtej Mureve” në bashkëpunim me organizatën SIT.
- Në qendrën korrektuese të të miturve në Lipjan, qendrën korrektuese në Dubravë dhe në Smrekonicë, janë organizuar Ekspozita të pikturave të cilat i kanë punuar vetë të burgosurit me temat për dhunën ndaj grave, dhunën në familje dhe dhunën me bazë gjinore, duke pasqyruar aspektin dhe ndikimin negativ të tyre.
- Në hapësirat e Qendrës Korrektuese në Lipjan është realizuar një Mural me tematikën e fushatës.
- Në qendrën korrektuese për të Mitur në Lipjan është organizuar Trajnim për pikturë për të miturit të cilët vuajnë dënimin aty si dhe është organizuar Ekspozitë e veçantë me motive të fushatës.



# BASHKË ORGANIZIM I AKTIVITETEVE



Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Shëndetësisë së bashku me UNFPA, bashkëorganizuan Konferencën “Preferencat Gjimore dhe Aborti Selektiv - Diskriminimi Gjinator dhe Praktika të Dëmshme ndaj Vajzave”. Paneli i diskutimit në këtë konferencë ishte i përbërë nga Ministria Haxhiu, Ministri Vitia, Ministria Nagavci, përfaqësues nga Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe UNFPA. Paneli u fokusua në preferencat gjimore dhe abortin selektiv – duke shqyrtuar statistikën, implikimet ligjore, perspektivat e kujdesit shëndetësor dhe ndikimin shoqëror, duke nxitur ndërgjegjësimin që të punojmë së bashku për të eliminuar diskriminimin gjinator dhe për të krijuar një shoqëri ku çdo individ vlerësohet, pavarësisht gjinisë. Fëmija vajzë dhe fëmija djalë duhet të jenë të barabartë. Aborti selektiv mirëmban tradita patriarkaliste.

Ministria Haxhiu ka marr pjesë në Diskutimin për Eliminimin e Dhunës ndaj Vajzave dhe Grave e cila është organizuar nga UN WOMEN, ku është diskutuar për rolin kyç të institucioneve në eliminimin e dhunës ndaj vajzave dhe grave, duke punuar në dy drejtime si në edukim ashtu edhe në fuqizimin e mekanizmave ligjor dhe avancimi në zbatimin e tyre.

Zëvendësministri i Drejtësisë, Vigan Qorrolli morri pjesë në hapjen e javës Kundër Braktisjes së Shkollimit e cila u organizua nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në kuadër të fushatës për të diskutuar për rolin e arsimimit dhe edukimit në parandalimin e rasteve të dhunës në familje, dhunës ndaj grave dhe dhunës me bazë gjimore.

Zëvendësministri i Drejtësisë Sallahu morri pjesë në Tryezën “Mbështetja institucionale e viktimave në sfidën e tyre psikologjike” e organizuar nga Misioni i EULEX-it në Kosovë dhe Instituti i Mjekësisë Ligjore, e cila është organizuar në kuadër të Fushatës.

Zëvendësministri i Drejtësisë, Vigan Qorrolli morri pjesë në Tryezën “Konventa e Stambollit: Cili është Roli i fakulteteve të drejtësisë në transformimin e angazhimit në realitet?” e cila u organizua në kuadër të fushatës nga OSBE dhe Kolegji AAB.

Ministria Haxhiu ishte e pranishme në Tryezën “Bashkohuni! Investoni për parandalimin e dhunës ndaj grave dhe vajzave” në qytetin e Vushtrrisë, ku me pjesëmarrës nga Shoqëria Civile, Policia, Qendra për Punë Sociale dhe të tjerë, është diskutuar për rëndësinë e edukimit të hershëm, pavarësinë ekonomike të grave të drejtat e viktimave dhe roli i zingjirit institucional për mbrojtje dhe ndihmë ndaj viktimave të dhunës me bazë gjimore.

Ministria Haxhiu morri pjesë edhe në Tryezën e Diskutimit të organizuar në Gjakovë “Sot dhe çdo ditë tjetër”.

Në hapësirat e Ministrisë së Drejtësisë në bashkëpunim me Rrjetin e Grave të Kosovës dhe ADA, është organizuar ceremonia e shpërndarjes së certifikatave për 13 zyrtarë të cilët janë trajnuar për punë me viktime të dhunës në familje, si dhe trajtim dhe referim i viktimave të dhunës seksuale dhe të trafikimit. Gjatë këtij trajnimit të organizuar në dy module, janë hartuar manualët udhëzuese për trajnerët e certifikuar.

## MBULUESHMËRIA MEDIALE

Gjatë Fushatës Globale “16 Ditët e Aktivizmit Kundër Dhunës me Bazë Gjinore” janë realizuar mbi 200 lajme dhe kronika të publikuara rreth aktiviteteve të Fushatës. Dhjetëra intervista në Radio e Televizione ku shpalosëm aktivitetet e diskutuam për çështje që kanë të bëjnë me dhunën ndaj grave, dhunën në familje dhe dhunën me bazë gjinore.

Kemi dërguar mesazhet tona tek mbi 2 milion përdorues të rrjeteve sociale përmes publikimeve, fotografive, infografave e videove të ndryshme.

Çdo ditë kemi postuar përmbledhje ditore të aktiviteteve me anë të videove përmbledhëse në rrjetet sociale.

## FLETUSHKA DHE MATERIALE

Janë dizajnuar dhe shtypur mijëra materiale shpenzuese dhe fletushka. Këto materiale janë shpërndarë në të gjitha aktivitetet tona me qëllim që secili person që bashkangjitet në aktivitetet tona të fushatës, të ketë të paktën një shenjë që u rikujton rëndësinë e adresimit të të gjitha formave të dhunës. Ndërsa materiale të tjera janë shfrytëzuar për vizuelizim sa më të mirë të aktiviteteve.

Kemi publikuar kalendarë ditore për aktivitetet dhe njoftime specifike për aktivitete më pjesëmarrje të hapur, duke arritur kështu që të ofrojmë mundësi që të gjithë qytetarët e interesuar të bashkohen.

Gjatë Konferencës Rajonale 2 ditore Ministria e Drejtësisë ka transmetuar drejtpërsëdrejti tërë zhvillimin e Konferencës, për të gjithë ata që kanë pasur interesim ta përcjellin dhe nuk kanë pasur mundësi të jenë aty fizikisht.


Këto materiale përfshijnë: shalla, faculeta, maica, çadra, kimika, fletore, stickers, butona, gota, mbajtëse për ID, fletushka të ndryshme, çanta krahu, roll-ups, banerë etj.

## ZHVILLIMI I DOKUMENTEVE

Për ta përforcuar thirrjen për veprim kolektiv për t'i dhënë fund fenomenit të dhunës, fushata u pasqyrua me dokumente informuese dhe orientuese. Në mënyrë simbolike janë dizajnuar dhe përdorur materiale me ngjyre të portokalltë duke u bartur dhe vendosur gjatë gjithë fushatës. Përmes fletëpalosjeve është prezantuar secili institucion bartës në shërbimet që ofron për rastet e dhunës në familje dhe ngacmimeve seksuale. E veçanta e dokumenteve është promovimi i shërbimeve me informata të rëndësishme që përshkruan në detaje

rregullimin ligjor për mbrojtjen nga çfarëdo forme e dhunës, ndihmën juridike falas, kompensimin e viktimave, shërbimet strehimit, mbrojtjen juridike dhe raportimin tek organet kompetente si dhe raportet statistikore të rasteve të dhunës me bazë gjinore

Po ashtu gjatë konferencës është shpërndarë dokumenti informues mbi përmbajtjen e konferencës rajonale, përbërja e paneleve, panelistët dhe temat e shtjelluara në çështjen e sigurisë, mbrojtjes dhe integritit.



# NË VEND TË CEREMONISË MBYLLËSE “SOT DHE ÇDO DITË TJETËR”

Në ditën e 16 të fushatës globale “16 ditët e aktivizmit kundër dhunës me bazë gjinore”, është planifikuar aktivitet përmbyllës i fushatës në Kuvendin e Kosovës.

Vrasja e Liridona Ademajt nga bashkëshorti, ishte thirrje për angazhim edhe më të madh në adresimin e dhunës në familje, dhunës ndaj grave dhe dhunës me bazë gjinore. Marrë parasysh rrethanat dhe sit-

uatën në të cilën gjindemi, angazhimi ynë intensiv nuk ndalon me 16 ditët por vazhdon. Andaj, në vend të ceremonisë përmbyllëse, Ministrja Haxhiu iu adresua qytetarëve përmes një videoje njoftuese rreth planeve dhe punëve tona të ardhshme, duke mos përmbyllur kështu fushatën por duke jetësuar në formën më konkrete të mundshme sloganin “SOT DHE ÇDO DITË TJETËR”

SOT DHE  
ÇDO DITË  
TJETËR







REPUBLIKA E KOSOVËS  
MINISTRIA E DREJTËSISË